



UNMIK



INSTITUCIONET E PËRKOQSHME VETËQEVERISËSE  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT  
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION  
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE  
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Kabineti i Ministrit

Office of the Minister

Kabinet Ministra

## UDHËZIM ADMINISTRATIV

**Ndalimi, ndërprerja e punës dhe iniciimi i procedurës disiplinore ndaj mësimitdhënësve dhe punëtorëve të tjerë në institucionet edukativo-arsimore, aftësuese dhe shkencore**

**NUMËR: MASHT [I] 40/2005**

**DATË: 28.09.2005**

Në bazë të nenit 2 dhe 5.3 pika b) dhe 5.4 pika g) të Ligjit mbi Inspektionin e Arsimit në Kosovë dhe në bazë të Urdhërësës Administrative nr.2003/2 mbi Zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenit 1.3 pika ç) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme Vetqeverisëse në Kosovë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (më poshtë MASHT), nxjerr:

### Neni 1

#### Qëllimi

Ky udhëzim administrativ ka për qëllim që të përcaktojë procedurat dhe kriteret për ndalimin, ndërprerjen dhe iniciimin e procedurës disiplinore ndaj personelit edukativo-arsimor, shkencor dhe aftësues.

### Neni 2

#### Ndalimi, ndërprerja dhe iniciimi i procedurës disiplinore

Inspektori i arsimit, ndalon, ndërpre punën e mësimitdhënësve dhe punëtorëve në institucionet edukativo- arsimore, shkencore dhe aftësuese si dhe e fillon procedurën e shqyrtimit të masës disiplinore ndaj tyre, nëse konstaton se:

- a) është punësuar pa konkurs publik dhe në kundërshtim me ligjin dhe aktet nënligjore;
- b) vërtetohet nga një raport mjekësor i pavarur, se mësimitdhënësi ose i punësuar tjetër nuk është në gjendje të kryejë detyrat e punës për shkak të gjendjes së tij/saj shëndetësore;
- c) mësimitdhënësi ose i punësuar tjetër është i dënuar për ndonjë veprë penale, për të cilin parashihet dënimi në kohëzgjatje me më shumë se 6 (gjashtë) muaj burg efektiv;
- d) nuk e zbaton ligjin dhe aktet e tjera nënligjore;
- e) përdor dhunën fizike ndaj fëmijëve, nxënësve, studentëve dhe kolegëve ;

- ë)** përdor dhe shpërndan armë, drogë e gjëra të tjera të ndaluara me ligj;
- f)** bën ndonjë akt ngacmimi apo dhunimi seksual;
- g)** nuk i zbaton udhëzimet dhe detyrat nga punëdhënësi dhe mbikëqyrësi arsimor;
- gj)** merr mito nga fëmijët, nxënësit, studentët dhe prindërit për përmirësim notash, kalim klase, dhënie provimi e të tjera të ngjashme;
- h)** i obligon fëmijët, nxënësit, studentët që të blejnë mjete, pajisje dhe tekste nga personeli edukativo-arsimor për çështje fitimprurëse;
- i)** u imponon nxënësve, studentëve të vet që të ndjekin kurse plotësuese nga mësimet për qëllime fitimprurëse;
- j)** keqpërdor mjete financiare të grumbulluara për ekskursione, kuzhina shkollore, punëtori apo çfarëdo forme tjetër;
- k)** keqpërdor pronën e institucionit edukativo-arsimor, shkencor dhe aftësues, mjetet mësimore, sportive, muzikore etj;
- l)** ndryshon të dhënat e dokumenteve në institucionet edukativo-arsimore, shkencore dhe aftësuese;
- ll)** lëshon dëftesa ose dokumente tjera në mënyrë të paautorizuar;
- m)** ndryshon notat e nxënësve apo studentëve në mënyrë të paligjshme;
- n)** dëmton ose asgjëson dokumentacionin shkollor qëllimisht dhe në kundërshtim me procedurat e përcaktuara me ligj;
- nj)** në mënyrë të paautorizuar jep të dhënat e besueshme si:
- të dhënat personale të fëmijëve, nxënësve dhe studentëve, familjes dhe kolegëve;
  - informatat shëndetësore dhe mjekësore;
  - problemet familjare;
  - rezultatet e notimit (testit) etj;
- o)** Bën diskriminim ndaj fëmijëve, nxënësve dhe studentëve për shkak të racës, gjinisë, ngjyrës, besimit, të hendikepuarve, origjinës vendore, statusit;
- p)** nxit urrejtje dhe dhunë kundër të tjerëve;
- q)** i shmanget në vazhdimësi planit dhe programit të miratuar në organet profesionale;
- r)** nuk ka aftësi të menaxhojë orën edukativo- mësimore dhe studimore;
- s)** në vazhdimësi nuk arrin të përmbush qëllimet e planprogramit dhe standardet e caktuara të arritshmërisë;
- sh)** nuk i kryen trajnimet e ofruara sipas dinamikës së paraparë me ligjet dhe akte të tjera nënligjore;
- t)** me sjelljen dhe veshjen e tij e çorienton vëmendjen e fëmijëve nga mësimi .

### **Neni 3**

#### **Njoftimi i inspektorit arsimor**

- 3.1. Inspektori i arsimit pas konstatimit të lëshimeve, e informon personelin edukativo-arsimor shkencor dhe aftësues, mbikëqyrësin dhe punëdhënësin me shkrim për lëshimet e konstatuara dhe më pas duhet të nxjerrë vendim për ndalim, ndërprerje të punës dhe inicon procedurën për masën disiplinore.
- 3.2. Inspektori arsimor menjëherë duhet t'i raportojë kryeinspektorit për masën e marrë, njëherit e informon edhe DKA-në dhe ZRA-në.

### **Neni 4**

#### **E drejta për ankim**

Pas marrjes së vendimit, pala ka të drejtë të ushtrojë ankesë te kryeinspektori i arsimit .

### **Neni 5**

#### **Hyrja në fuqi**

Ky udhëzim administrativ, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

---

**Agim Veliu, ministër**